



KËSHILLI I BASHKISE

10.09.2016
Bujqesi

Nr. 6401/2

VENDIM
Nr 74 dt 27/09/2016

DA. 27.09.2016

Per miratimin e fillimit te procedurave te marrjes me qira te siperfaqes truall ,ne Zonen Kadastrale Nr.8531,per pasurite Nr.8/2;8/4 me siperfaqe totale 3,466.00 m2 per ndertimin e tregut te produkteve bujqesore dhe blegtorale .

Keshillit te Bashkise Fier , I paraqitet per shqyrtim materiali nga ekzekutivi I Bashkise Fier , per miratimin e fillimit te procedurave te marrjes me qira te siperfaqes truall, ne Zonen Kadastrale Nr.8531,per pasurite Nr.8/2;8/4 me siperfaqe totale 3,466.00 m2 ,per ndertimin e tregut te produkteve bujqesore dhe blegtorale , ne kuader te strategjise se zhvillimit te territorit te Bashkise Fier dhe ushtrimit te funksionit te zhvillimit ekonomik vendor , per ngritjen dhe funksionimin e tregjeve publike dhe te rrjetit te tregtise.

Bazuar ne Ligjin Nr.139/2015 “ Per Veteqeverisjen Vendore “, neni 9 pika 1.6 germa “a” , neni 28 pika 2, dispozitave te kodit civil neni 801 e vijim per kontraten e qirase si dhe materialeve perkatese te ekzekutivit:

VENDOSI:

- 1-Te miratoje fillimin e procedurave te marrjes me qira te siperfaqes truall , Zona Kadastrale Nr.8531,per pasurite Nr.8/2;8/4 me siperfaqe totale 3,466.00 m2 ,per ndertimin e tregut te produkteve bujqesore dhe blegtorale , siperfaqe e cila duhet te jete e lire truall (pa ndertese) dhe pa asnje kufizim ligjor , apo barre hipotekore;
- 2-Te autorizoj ekzekutivin e Bashkise te ndjeke te gjitha procedurat ligjore ,deri ne lidhjen e kontrates se qirase sipas legjislacionit ne fuqi , duke caktuar si afat te kesaj kontrate afatin 10 (dhjete) vjet dhe tarife te qirase vleren tavan te percaktuar ne VKM Nr. 54 , date 5/2/2014 “ Per percaktimin e kritereve, te procedurave te dhenies me qira , enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shtetere “ i ndryshuar , kreu III , pika 2 , 100 leke/m2 ;
- 3-Per zbatimin e ketij Vendimi ngarkohen Drejtorite perkatese ;
- 4-Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

KRYETARE

EVIS SEMA

